



REPUBLIKA E SHQIPERISE

MINISTRIA E FINANCIVE
DREJTORIA E PERGJITHSHME
E DOGANAVE

DEGA E DOGANES DURRES

Nr. 1124. Prot., date 07.05.2010

MINISTRIA E BRENDSHME
DREJTORIA E PERGJITHSHME E POLICISE

DREJTORIA RAJONALE E KUFIRIT
DHE MIGRACIONIT DURRES

Nr. 34 Prot., date 10.05.2010

URDHER I PERBASHKET

Per implementimin ne procedurat e perbashketa lokale midis Policise Kufitare dhe Sherbimit Doganor ne Piken e Kalimit Kufitar Durres, te Sistemit Elektronik Lokal te Regjistrimit per vendosjen nen Regjimin e Lejimit te Perkohshem te automjeteve rrugore, per perdorim privat te cilat nuk regjistrohen ne Sistemin TIMS.

Ligjit nr.8449 date 27.01.1999 "Kodi Doganor i Reputikes se Shqiperise", Ligjit nr.9861 date 24.01.2008 "Per kontrollin dhe mbikqyrjen e kufirit shteteror", V.K.M-se nr.205 date 13.04.1999 "Per Dispozitat Zbatuese te Kodit Doganor", V.K.M-se nr.1022 date 14.10.2009 "Per nje shtese ne Vendimin nr.205 date 13.04.1999, te Keshillit te Ministrave - Per Dispozitat Zbatuese te Kodit Doganor, te ndryshuar", Udhezimit nr.4 date 04.02.2010 te Ministrit te Financave dhe Ministrit te Brendshem "Per zbatimin e procedurave te miratimit, mbikqyrjes dhe permbylljes se Regjimit te Lejimit te Perkohshem te automjeteve te huaja per perdorim privat",

Nisur nga:

Pamundesia e regjistrimit ne Sistemin TIMS te automjeteve rrugore te pashoqeruara nga pronari te ardhura me post, konteiner, te rimorkuara, cargo si dhe me synimin per evidentimin e plote te mjeteve per perdorim privat qe hyjne dhe dalin nga Territori i Reputikes se Shqiperise nepermjet Pikes se Kalimit Kufitar Durres,

Me qellim:

- Zbatimin me korrektesi te kerkesave ne aktet dhe nen aktet ligjore te sipercituara, zbatimin e strategjise kombetare per trafi.kimin e mjeteve motorike, identifikimin e personave objekt i ketij trafiku, harmonizimin e kerkesave te procedurave te perbashketa ne sherbim te analizes se riskut, eliminimin e shmangies nga detyrimet doganore, rritjen e sigurise ne Zonen Kufitare e Portuale Durres,
- Mbajtjen nen kontroll te mjeteve lundruese qe transportojne automjete duke rakorduar deklarimin permbledhes ne manifestet e trageteve dhe anijeve me evidentimin faktik,
- Eliminimin e perdorimit te manifesteve per gjetjen e automjeteve me Regjim te Lejimit te Perkohshem nepermjet perdorimit te te dhenave ne Sistemin Elektronik Lokal per paisjen e shtetasve qe lejojne zhdoganimin, brenda nje kohe sa me te shkurter,
- Venien e te dhenave te sakta qe kerkohen per automjetet brenda nje kohe sa me te shpejte ne dispozicion te strukturave kontrolluese e investiguese, si dhe lehtesimin e procedurave te perbashketa per shtetasit dhe punonjesit e Doganes e te Policise Kufitare,

URDHEROJME:

Te behet regjistrimi i te gjitha mjeteve pa drejtues te tyre (mjete te postuara, te rimorkuara, cargo, te ardhura me konteiner, etj) nga ana e Policise Kufitare ne momentin e hyrjes dhe daljes nga Republika e Shqiperise ne Sistemin Elektronik Lokal.

Per te gjithë automjetet rrugore per perdorim privat, qe kalojne kufirin nepermjet Doganes Durres dhejane transportuar me post apo te pashoqeruara nga pronari, ne momentin e paraqitjes per tu depozituar ne ambientet e Magazinimit te Perkohshem, nga punonjesi i Policise Kufitare do te duhet regjistrimi ne Sistemin Elektronik Lokal. Pas identifikimit fizik te mjetit dhe perputhshmerise me dokumentacionin shoqerues, punonjesi i Policise ploteson me korrektesi ne kete Sistem rubriken "Regjistrim i Ri" duke vendosur daten e hytjes ne kufi, personin qe e ka derguar, mjetin transportues me te cilin ka ardhur, llojin e mjetit te postuar, marken, shtetin e origjines, vitin e prodhimit, targon, numrin e shasisë dhe ngjyren paresore, duke i dhene mjetit "Status Hyrje", qe presupozon kalimin nga Kufiri ne Zonen Doganore te mjetit, ne pritje per te lli.arre destinacionin e duhur doganor.

Ne rastet e evidentimit nga kontrolli dokumentar se personi me mjetin e paraqitur ne sportel nuk ploteson kushtet per te perfituar Regjimin e Lejimit te Perkohshem, nga ana e punonjesit te policise dhe doganierit do te mbahen shenimet per mjetin dhe do te udhezojne kthimin e mjetit ne parkingun doganor. Te njejten gje do te bejne shtetasit qe kane mjete te rimorkuara pas makines se tyre te cilat e perfitojne regjimin, do te orientohen te shkojne per te regjistruar mjetin e rimorkuar ne Sistemin Elektronik Lokal

Te gjitha te dhenat qe hidhen ne Sistemin Elektronik Lokal kalojne automatikisht tek doganieri i kontrollit flzik ne Piken e Daljes dhe tek kontrollori i Policise Kufitare qe jep lejet e qarkullimit provizor te mjeteve. Per te gjithë automjetet e huaja per perdorim privat me "Status Hyrje" ne Magazinim te Perkohshem, per te cilat paraqitet kerkesa per vendosjen e tyre nen Regjimin e Lejimit te Perkohshem, nga ana e doganierit te Pikes se Daljes ne bashkepunim me kontrollorin e Policise Kufitare per tu dhene te drejten e daljes mjeteve nga sheshi doganor do te layejne keto verifikime:

1. Ka ose jo prokure te posa me nga personi dergues.
2. Ka ose jo autorizim nga shoqeria apo institucioni ne pronesi te te cilit eshte mjeti edhe ne rastet kur mjeti eshte dhene me qera.
3. Personi i paraqitur per terheqjen e mjetit te ardhur me post apo i pashoqeruar, detyrimisht duhet te jete pronari i mjetit ne fjale.
4. Nese plotesohen kushtet e pikes nr.1, nr. dhe nr.3, fotokopjohen prokura e posa me apo autorizimi se bashku me nga nje fotokopje te pasaportes, librezes se mjetit, ertifikates se pronesise se mjetit duke i vendosur ne dosjen perkatese dhe emri i personit qe merr mjetin shenohet ne regjistrin elektronik lokal.

Per automjetet e huaja per perdorim privat me drejtues qe regjistrohen ne Sistemin TIMS nuk e perfl.tojne Regjimin e Lejimit te Perkohshem ne rastet kur:

1. Automjete jane te regjistruara (pa targa ose me targa provizore).
2. Kur automjetet mberrijne te pashoqeruara (nepermjet formave te transportit ne kufi, ne traget apo konteiner) nga nje perdoruesjteter i autorizuar prej tij.
3. Kur konstatohet nje person i cili importon, brenda nje periudhe 6-muaj, me shume se nje mjet dhe per te cilet nuk eshte mbyllur Regjimi i Lejimit te Perkohshem. Ndaj ketyre personave do te mbahet proesverbali i konstatimit dhe do te njoftohen menjehere pergjegjesat perkates te turnit. Ky mjet do te kaloje ne parkingun doganor per veprime te metejshme doganore dhe regjistrimi i tij do te behet ne Sistem Elektronik Lokal.

Pas verifikimeve te perbashketa si ne Sistemin TIMS dhe ne Sistemin Elektronik Lokal duke interpretuar me rigorozitet kriteret e lartpermendura, doganieri i Pikes se Daljes dhe kontrollori I Policise Kufitare, veprojne ne perputhje me kerkesat e Udhezimit nr.4 date 04.02.2010 dhe sipas rastit shenojne ne Sistemin Elektronik

Lokal keto shenja:

- a.Kur mjeti zhdoganohet- vendos shenjen "DAV" (numrin dhe daten e DAV-it),
- b.Kur mjeti lejohet ne regjimin e perkohshem - vendos shenjen "RLP" (data e daljes),
- c.Kur mjeti tranzitohet- vendos shenjen "TI" (numrin dhe daten e T1),
- d. Kur mjeti prapsohet- vendos shenjen "AP" (data e aktit te prapsimit).

Ne rastin e pikes d perpilohet Akti-Prapesimit te automjetit i cili nenshkruhet nga doganieri i Pikes se Daljes dhe kontrollori i Policise Kufitare. Nje kopje e Akt-Prapesimit i jepet shtetasit qe i ndalohet kalimi i mjetit me Regjim te Lejimit te Perkohshem, duke i dhene te drejten e ankimit tek Pergjegjesat e Pikes se Kontrollit te Doganes dhe Policise Kufitare. Pasi pergjegjesat layejne kontrollin e dokumentacionit perkates dhe te veprimeve, vleresojne plotesimin e kushteve per te perfltuar automjeti Regjimin e Lejimit te Perkohshem, duke konfirmuar ne proes-verbal daljen ose jo te mjetit.

Ne vijim te kesaj procedure si nga Dogana ashtu edhe nga Policia behen ne Sistemin Elektronik Lokal sipas rastit shenimet e sipercituara ne rubriken perkatese.

Nga ana e personelit doganor dhe kufitar te autorizuar per perpunimin e te dhenave ne Sistemin Kompjuterik Lokal do te administrohet me korrektesi konfidencialiteti i se drejtes se aksesit ne kete Sistem te sigurt dhe te garantuar.

Dhenia e te drejtes se aksesit ne Sistemin Elektronik Lokal per punonjesit perkates do te percaktohet ne akte administrative te perbashketa midis Deges se Doganes Durres dhe Drejtorise Rajonale te Kufirit dhe Migracionit Durres.

-Per funksionimin dhe mirembajtjen e Sistemit Elektronik Lokal, garantimin per ruajtjen e te dhenave te hedhura ne sistem, administrimin e te drejtes se aksesit dhe sigurine e ketij programi, ngarkohen z.Saimir DUKA per Degen e Doganes Durres dhe znj.Dea GJURA per Drejtorine Rajonale te Kufirit dhe Migracionit Durres.

-Per zbatimin dhe raportimin ditor te kerkesave te ketij Urdheri te Perbashket ngarkohen pergjegjesat ne Piken e Kontrollit Hyrje-Dalje te Doganes dhe Policise Kufitare.

-Bashkengjitur ketij Urdheri ndodhet "Manuali perdorues i Sistemit Kompjuterik Lokal te Regjistrimit".

Ky Urdher hyn ne fuqi menjehere.

SHEFI OPERACIONEVE DOGANORE
Alban DALANI

SHEFI I OPERACIONE KUFITARE

Elvis KALAMISHI

ADMINISTRATOR TE SISTEMIT ELEKTRONIK LOKAL

Saimir DUKA
Dea GJURA

PIKA E KALIMIT KUFITAR E DOGANOR DURRES

LENDA: *Akt - Prapsimi*

Sot me daten __/__/2010 ne sportelin e kontrollit kufitar e doganor ne Piken e Kalimit Kufitar Durres, ne prani te doganierit _____ dhe Policit Kufitar, u paraqit shtetasi_____, i datelindjes_____, vendlindja_____,vendbanimi_____, me dokument Identifikimi Lloji_____, nr_____, per te terhequr automjetin me targe_____, te derguar nga shtetasi_____.

Nga kontrolli i dokumentacionit dhe verifikimet e meparshme ne Sistemin Asycuda World ne Sistemin TIMS dhe eElektronik Lokal rezulton si me poshte:

1. _____
2. _____
3. _____
4. _____
5. _____
6. _____
7. _____
8. _____
9. _____
10. _____

DOGANIERI
emer,mbierner,firme

KONTROLLORI I POLICISE
emer mbierner, firme

PERGJEGJESI I TURNIT NE DOGANE
emer mbierner, firme

**PERGJEGJESI I TURNIT NE
POLICI**
emermbierner, firme